

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti I Procedurës: “Shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi ”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): Klor

Vlera E Fondit Limit: 1.979.000 (Nje million e nenteqind e shtatedhjetë e nente) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKGJ sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim:Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë SHRUKGJ sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të neni 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 7

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1-Operatori ekonomik duhet te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise ne QKB objektin e prokurimit.

2.2.2- Ofertuesi duhet të paraqesë nje vertetim qe ka paguar detyrimet e ujit te pijshem dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.)

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

2.2.3-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më shumë se 20% e fondit limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të

ngjashme të jenë ne vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit për të cilën oferton., që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe të paraqesë në sistemin elektronik konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) ISO 14001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- c) ISO 45001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën e specifikimeve teknike.
3. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

4. Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.
5. Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009”Për Shëndetin Publik”, ligji nr.10081, datë 23.02.2009”Për liçensat , autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu mbështetur edhe në pikën 1 të Vendimit nr. 415, date 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin eeksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për dezinfektim,dezinfektim dhe deratizim" parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinfektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky kriter është vendosur në mbështetje të vendimit nr. 379 date 25.05.2016 neni 14, pika 1 në të cilën sanksionohet: “Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide” dhe kimikatet objekt prokurimi (produkte biocide) që u lejohet leja e importit janë të përcaktuara në urdhërin nr.202 date 23.05.2014 nga Ministria e Shëndetësisë “Për autorizimin e importit të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin në Shëndetin Publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Referuar vendosjes të lejes mjedisore të tipit A në rastin kur operatori ekonomik është prodhues vendas apo kur operatori ekonomik është tregtues vendas kriteri është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujën e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (operatori ekonomik është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin e mesiperm për ato

elementë toksikologjike që realizon ISHP) ose (çertifikatën e analizës toksikologjike të produkteve lëshuar nga laboratorë të akreditur sipas legjislacionit në fuqi të Republikës të Shqipërisë) jo më vonë se 3 muaj.

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 “të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilën parashikohet shprehimisht... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet të autorizuar për transport kimikatesh për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.
8. Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij , certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Githashtu referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës janë përcaktuar përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në destinacionin perkates.

Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

NJESIA E PROKURIMIT

Bexhet Baxhella

Brisilda Papa

Nelson Sejdo